



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve  
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije  
National Qualification Authority

Numër: 01/224

Datë: 29.04.2022

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak në Kosovë nr. 09/2019, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2022 nxjerrë këtë:

### V E N D I M

1. **Akreditohet** institucioni "Gjimnazi Britanik për Teknologji", me adresë: Rruga Astrit Rrushi, Nr.16, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovë, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 01.09.2022 deri 31.08.2025, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

**1.1 Teknologji e Informacionit**, Niveli IV sipas KKK, lloji: Kualifikimet e Bazuara në Standardet Ndërkombëtare (E) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e arsimit dhe aftësimit me nga njëzetepesë (25) kandidat në një klasë. Institucionit për vitin e parë i lejoheq që të ketë tre (3) klasa, ndërsa për vitin e dyte dhe tretë të akreditimit i lejoheq që të ketë deri në katër (4) klasa me nga njëzetepesë (25) kandidat.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së "Gjimnazi Britanik për Teknologji", për akreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues

dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.


Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit, Gjimnazi Britanik për Teknologji, dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

  
Kryetar KD së AKK

